



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr. 97/1 prot.

Shkodër, më 13.2.2026

Lënda: Mbi Vendimin Nr.11, datë 29.01.2026 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJES.

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja "dh", neni 64, shkronja "c", të ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, VKM Nr.414/2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, VKB i buxhetit Nr.74 date.23.12.2025, dokumentacionin e dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Nr.688prot datë.3.02.2026, shqyrtoi **vendimin Nr.11, datë 29.01.2026** të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës: "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Vau-Dejës së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës, për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z.Mark Zef Prendi, banues Vau-Dejës, sipas vërtetimit për rënie zjarri Nr.7232/1prot datë.24.12.2025" me ndihmë të menjëhershme dhe kompensim të dëmeve në masën 50% e vlerësimit sipas shkronjës "ç", pika 3, Kreu III të VKM Nr.329/2012.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



PREFEKTI
Holta DUDA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 11 datë 29.01.2026

“Mbi dhënien e ndihmës financiare familjes së z.Mark Zef Prendi qe i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rene me dt.16.12.2025 “

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”,pika 3, Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e koston së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.2 dt.16.01.2026, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin Mark Zef Prendi banorë i Qytetit Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës,Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

- 1.Miratimin** e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z.Mark Zef Prendi** (2 anëtare në familje) në vlerën **20.000** (njëzetmijë) lekë për dëmtimin pjesërisht të banesës së tij nga zjarri.
- 2.Miratimin** e proces verbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, të hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e kryetarit te Bashkisë Nr.849 prot dt.18.12.2025 në vlerën totale të dëmit 530.715 (pesëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë për shtetasin **Mark Zef Prendi** banorë i qytetit Vau Dejes të Bashkisë Vau-Dejës .
- 3.Miratimin** e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin **Mark Zef Prendi** banorë i qytetit Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **265.357,5** (dyqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë pikë pesë) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia me dt.16.12.2025.
- 4.Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
- 5.Burimi i financimit** do të jetë fondi i Bashkisë i planifikuar për programin e Mbrojtjes Civile i miratuar ne Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.74 dt.23.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit 2026” konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresën 884/1 dt.07.01.2026 .
- 6.Ngarkohen** Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e ketij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" ndryshuar).

Kryetar Këshilli
Ervis Shumaj



Sekretar Këshilli
Arrian Çelepija

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 03.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIMI
Nr.2 datë 16/01/2026

Mbi "Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Mark Zef Prendi i dëmtuar nga zjarri me dt.16.12.2025 banorë i Bashkisë Vau-Dejës"

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 41, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pika 3, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016" si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,"

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesën e shtetasit **Mark Zef Prendi** me dt.16.12.2025 që është banorë i Qytetit Vau Dejës të Njesisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Vau Dejës për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z.Mark Zef Prendi** (2 anëtarë në familje), në vlerën **20.000** (njëzet mijë) lekë për dëmtimin pjesërisht të banesës së tij nga zjarri .
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau Dejës , për familjen e **z.Mark Zef Prendi** në vlerën totale të dëmit **530.715** (pesëqind e tridhjetëmijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.
3. Të miratojë dhënien e kompensimit sipas proces verbalit të vlerësimit i hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në masën **50%** të vlerës totale në shumën **265.357.⁵** (dyqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e treqind e pesëdhjetë e shtatëmijë pikë pesë) lekë.
4. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i Bashkisë i planifikuar për programin e Mbrojtjes Civile i miratuar ne Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.74 dt.23.12.2025" Mbi miratimin e buxhetit 2025" konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresën 884/1, datë 07.01.2026.

Konfirmoi bazen ligjore

Eralda Mita

Konfirmoi bazen financiare

Shk. R. R. R.

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

Valjeta Nikaj

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI



KRYETARI

Kristian SHKRELI

Relacion

Vau dejes ,me 18.12.2025

Objekti: "Ndërtesë (apartamenti) 5 katësh ,ku jeton familja e z.Mark Zef Prendi.

Vendodhja: Nj.A, Qender, Z.K 8598, Nr. pas 44 Ndertesë ; Apartament,Bashkia Vau-Dejes

Bazuar në urdhrin e punës nr.849 dt.18.12.2025 të ngritur nga titullari i Bashkisë Vau Dejës me nr. 386 datën 24.06.2025, grupi i punës verifikoi gjendjen në banesën e z.Mark Zef Prendi.

Banesa ndodhet në Qytetin Vau Dejës të Njësisë Administrative Qendër të Bashkisë Vau Dejës, në zonën kadastrale 8598 me sipërfaqe ndertese **57.5 m²** në pronësi të z. **Mark Zef Prendi**.

Gjatë inspektimit në terren u kryen matjet e banesës, nga të cilat rezultoi se banesa është me përmasa (sipas planimetrisë bashkëngjitur),me sipërfaqe totale rreth **57.5 m²**. Banesa është e ndërtuar me mur tulle çeramike, i cili edhe pse është i përfshirë nga zjarri pjesërisht me dëmtime strukturore, por si shkak i zjarrit është djegur pjesërisht (kuzhina, korridori dhe salloni).

Zjarri (temperatura ka dëmtuar) dyert e brendshme tamburato të objektit, Në kushte të tilla, kjo banesë ka nevojë për riparime të pjesëshme.

Në vlerësimin e dëmëve të objektit, janë marrë parasysh çmimet e referencës nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe në përzgjedhja e zërave të punës është bërë në mënyrë të tillë, që banesa të rikthehet në gjendjen e saj fillestare, para se të përfshihej nga zjarri.

Punimet ndërtimore që duhet të kryhen në këtë banesë janë si më poshtë:

- Lyerje me Bojë plastike(korridor+kuzhine+sallon)
- Dyer të brendshme tamburato te thjeshta/me dekor

Punoi :Ing. Indrit Kurtbegu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU-DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. Prot

Vau Dejës, me 18.12.2025

PROCES VERBAL KONSTATIMI

I Mbajtur sot me datë 18.12.2025 në Qytetin Vau Dejës të Njësisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës nga komisioni i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr.849 dt.18.12.2025 për konstatimin e kërkesës me nr praktike 3114 të dt.17.12.2025 të shtetasit **Mark Zef Prendi** mbi rënien e zjarrit në banesën e tij me dt.16.12.2025.

Gjatë verifikimit në vend u konstatua:

Banesa është apartament 5 katësh e ndërtuar në vitin 1995 ku janë 2 dhoma (1+1)+banjo+korridor +ballkon me sipërfaqe 57.5 m².

Zjarri ka rënë në banesën e shtetasit **Mark Zef Prendi** me dt.16.12.2025, ku fatmirësisht nuk ka humbje jetësh. Banesa është dëmtuar pjesërisht nga ana ndërtimore. Zjarri ka rënë në pjesën e sallonit dhe të kuzhinës ku janë dëmtuar si dhe pothuajse të gjitha mobileritë,orenditë dhe pajisjet elektro-shtëpiake që ndodheshin në kuzhinë ,salon dhe korridor.si më poshtë:

Nr	Emertimi	Sasia (copë)
1.	Televizor Samsung 40 "	1
2.	Frigorifer LG	1
3.	Frigorifer Samsung	1
4.	Sobe Gorenje	1
5.	Furre Gorenje	1
6.	Microvale Gorenje	1
7.	Aspirator Gorenje	1
8.	Kondicioner	1
9.	Komplet kolltuqe	1
10.	Minibare kine	1
11.	Minibar	1
12.	Tavoline mesi	1

13.	Tavoline buke	1
14.	Karrige	4
		14(cope)

Bashkëlidhur këtij proces verbali do të gjeni edhe kopjen e Planimetrisë së banesës së shtetasit Mark Zef Prendi banorë në Qytetin Vau Dejës të Njësisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës.

KOMISIONI

Valjeta Nikaj



Indrit Kurtbegu



Ardian Firza



MIRATOHET
KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Vau-Dejes, me 18.12.2025

MIRATOHET

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIM
ZV/KRYETARI
Aleksandra GJONI



Vlerësimi i dëmeve në mobileri, orendi, pajisje elektroshtëpiake

Në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", vlerësimi i dëmeve sipas komisionit të vlerësimit për: mobileri ,orendi, pajisje elektro-shtëpiake të dëmtuara nga zjarri në objektin e banimit të z.Mark Zef Prendi është:

Nr	Emertimi	Sasia (lope)	Çmimi	Vlera
1.	Televizor Samsung 40 "	1	84.700	84.700
2.	Frigorifer LG 303L	1	52.260	52.260
4.	Sobe Gorenje	1	43.980	43.980
5.	Furre Gorenje	1	24.000	24.000
6.	Mikrovale Gorenje	1	39.600	39.600
7.	Aspirator Gorenje	1	18.840	18.840
8.	Kondicionere Vivac 18 INV	1	69.900	69.900
9	Komplet kolltuqe	1	48.300	48.300
10.	Minibare kine	1	38.000	38.000
11.	Minibar	1	32.000	32.000
12.	Tavoline mesi	1	10.000	10.000
13.	Tavoline buke	1	18.000	18.000
14.	Karrige me tapiceri	4	2.200	8.800
Shuma				488.380

Vlerësimi i mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake është bërë në bazë të shkresës Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"

Vlerësimi i zërave të punimeve është bërë në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kapitulli III, pika 2 germa ç, si dhe Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016, ku vlera e objektit të dëmtuar sipas zërave është 42.335 (katerdhjete e dy mijë e trëqind e tridhjetë e pesë) leke sipas tabelës së poshtëshënuar

Nr	Nr.An	Përshkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1.	404/1	Lyerje me Bojë plastike(korridor+kuzhine+salon)	m ²	95	150	14.250
2.	An	Dyer te brendshme tamburato gjysem xhami veshje me rimeso.	m ²	2.2	12.766	28.085
		SHUMA				42.335

ndërsa vlera e dëmëve në mobilje, orendi dhe pajisje elektroshtëpiake është **488.380** (katërqind e tetëdhjetë e tetëmijë e treqind e tetëdhjetë) leke dhe vlera totale e dëmit është **530.715** (peseqind e tridhjetëmijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

Komisioni:

Valjeta **Nikaj**



Indrit **Kurtbegu**



Ardian **Firza**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Nr. 232/prot.

Vau-Dejës, me 24/12/2025

VËRTETIM

Për rënie zjarri

Vërtetohet me datë 16/12/2025 në orën 16¹⁵ jemi njoftuar për zjarr në shtëpi banimi. Zjarri ishte në një pallat në katin e 5 (pestë), e përbërë nga tre dhoma, koridor dhe banjo, me pronar Mark Prendi me Nr. ID. G70105111Q me adresë Vau Dejës, Njesia Administrative Vau Dejës, Bashkia Vau-Dejës. Me të mbërritur në vengjarje konstatuam se zjarri ishte fikur nga familjarët. Zjarri kishte rënë në pjesën e sallonit dhe guzhinës. Si pasojë e zjarrit të rënë në pallat në katin e 5 (pestë) u dogjën një pjesë e bankut, frigorifer, kondicioner si dhe prani bloze në të gjithë dhomën. Në ambientet e tjera të shtëpisë nuk ka probleme. Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që vërteton rënien e këtij zjarri.

Ky vërtetim mbahet në 3 (tre) kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve për ta përdorur sipas nevojave.

SHEFI SEKTORIT TË MZSH-së

Glen RROTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

Nr. 7259 Prot

Vau-Dejes, me dt. 18/12/2025

URDHËR
Nr. 849, date 18/12/2025

Mbështetur në ligjin Nr.45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen Civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore". Udhëzimi Nr.1185/1 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të Emergjencave Civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme", i ndryshuar, për verifikimin e rastit të dëmtimit nga zjarri dt.16.12.2025 në banesën e shtetasit **Mark Zef Prendi** banorë në Qytetin Vau Dejës të Njesisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau Dejës sipas kërkesës me nr. Praktike 3114 dt.17.12.2025.

URDHËROJ:

- I. Ngritjen e komisionit të mëposhtëm për verifikimin e e rastit të dëmtimit nga zjarri të banesës së shtetasit **Mark Zef Prendi** banorë i Qytetit Vau Dejes të Njesisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejes
 - a. Valjeta Nikaj Kryetare
 - b. Indrit Kurtbegu Anëtar
 - c. Ardian Firza Anëtar
- II. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri komisioni i lartpërmendur.
- III. Afati për përpilimin e proces verbaleve të konstatimit dhe të vlerësimit të rasteve është data 20/12/2025.
- IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi
Valjeta Nikaj

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI